



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.28, datë 14.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES NR.SERIE
0051, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË 22.09.2017 PËR
PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR, SUBJEKTIT
“PRELASHI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime teknologjike (Karburant) me Nr.serie:0051, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.3, datë 22.09.2017, subjektit “Prelashi” sh.p.k, me vendndodhje, Autostrada Lezhë-Tiranë, km-8, Njësia Administrative Gajush, Bashkia Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X= 472446.9

- Y= 4618223.2

- Z=1 m.m.n.d

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 2$ l/sek

- Sasia e ujit në përdorim : $Q = 0,3$ l/sek

- Qëllimi i përdorimit : Ujë teknologjik (Karburant)

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

